



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Dt, 05.08.2022

### Thirrje për aplikim

#### Për fermerët e Komunës së Prizrenit

Për përfitim në kuadër të implementimit të projektit

"Ngritja e pemishteve me pemë të imta-dredhëz" me bashkëfinancim .

*Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e komunës së Prizrenit të cilët i plotësojnë kriteret e mëposhtëm:*

- Të jetë banor i Komunës së Prizrenit.
- Ngastra të ketë qasje në rrugë gjatë tërë vitit.
- Ngastra të jetë nën sistemin e ujitjes apo në forma tjera të ketë ujë gjatë sezonës kur i nevojitet uji.
- Sipërfaqja e propozuar për mbjellje duhet të plotësojë kriteret siç janë:(pleshmeria,lartësia mbidetare,pozicioni gjeografik)
- Të jetë i gatshëm të marrë pjesë në bashkëfinancim (20%) nga vlera e përgjithshme në afatin optimal të caktuar nga Drejtoria e Bujqësisë.
- Sipërfaqja që duhet mbjellë duhet të jetë min 0.10 ha maksimum 0.30 ha.
- Sipërfaqja që do të mbillet duhet të jetë e lirë në momentin kur kompania fillon ti kryej operimet ( lëvrimin, plehërimin etj), kjo do të verifikohet nga komisioni i Drejtorisë.
- Të jetë i gatshëm ti përmbush të gjitha obligimet nga Marrëveshja e cila nënshkruhet.

#### *Dokumentacioni i nevojshëm*

- Kopja e letërnjoftimit.
- Fleta poseduese dhe kopja e planit të ngastrës ku do të bëhet mbjellja, në emër të tij apo të prindërit, apo me kontratë të noterizuar së paku për 5 vite.
- Dëshmia nga Aplikacioni për Pagesa Direkte, dy vitet e fundit për dredhëza, për personat që kërkojnë mbi 0.20 ha.
- Dëshmia mbi pagesën e tatimit në pronë.
- Vërtetimi i pagesës së mbeturinave.

Afati i aplikimit nga dt, 08 – 17 Gusht -2022

